Thirrje për Aplikime

Programi i Zhvillimit të Lidershipit për Punësim Gjithëpërfshirës: Strategji Praktike të Burimeve Njerëzore dhe Mbajtjes së Stafit për Punëdhënësit dhe Bashkitë në Ballkanin Perëndimor për Sigurimin e Fuqisë Punëtore të së Ardhmes

1. Konteksti

Në një kohë kur punëdhënësit në Ballkanin Perëndimor po përballen me largimin e trurit, mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe rënien demografike, gratë dhe grupet e cenueshme ende përballen me barriera strukturore në tregun e punës. Në këtë kontekst, rritja e pjesëmarrjes së grave dhe grupeve të cenueshme në tregun e punës nuk është më vetëm një objektiv shoqëror; bëhet një domosdoshmëri ekonomike!

Në kuadër të integrimit me BE-në, vendet e Ballkanit Perëndimor janë të detyruara të përmbushin standardet dhe direktivat e BE-së në fushën e pjesëmarrjes ekonomike. Për bizneset private, përputhja me këto standarde përmirëson integrimin në zinxhirin e furnizimit me partnerët e BE-sea dhe rrit aksesin në tregjet e eksportit. Nevojitet veprim veçanërisht në lidhje me sigurimin e mundësive të barabarta, punësimit të sigurt dhe të adaptueshëm, balancës punë-jetë, dialogut social dhe përfshirjes së punëtorëve.

Ndërsa qeveritë kombëtare janë të detyruara të vendosin standardet ligjore për integrimin më të mirë të grave dhe grupeve të cenueshme në tregun e punës si dhe të sigurojnë përputhshmërinë me standardet e BE-së, janë bashkitë dhe bizneset së bashku që duhet të krijojnë një mjedis gjithëpërfshirës që u mundëson grave dhe grupeve të cenueshme të gjejnë dhe të mbajnë një punë.

Në këtë drejtim, projekti rajonal "Avancimi i Pjesëmarrjes Socio-Ekonomike në Bashkitë e Ballkanit Perëndimor" (SPARK), i zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ), synon të forcojë kapacitetet institucional të bashkive dhe aktorëve të sektorit privat për të promovuar dhe prezantuar praktika punësimi gjithëpërfshirëse në kontekstet e tyre lokale.

Në këtë drejtim, GIZ shpall Thirrjen për **Aplikime për Programin e Zhvillimit të Lidershipit për Promovimin e Punësimit Gjithëpërfshirës** (Programi LEAP).

2. Vështrim i shpejtë mbi programin:


Programi LEAp ka target bashkitë dhe partnerët e tyre të biznesit në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

Programi është dizajnuar si një program modular rritje kapaciteti që përbëhet nga dy (2) trajnime fizike dhe një online, të plotësuara me seanca mentorimi, deri në zbatimin e aktiviteteve të zhvilluara.

Programi zhvillohet gjatë një periudhe prej nëntë (9) muajsh nga Shkurti 2027 deri në Tetor 2027 me gjithsej 3 trajnime të planifikuara: Shkurt 2027 (fizikisht), Prill 2027 (online) dhe Qershor 2027 fizikisht), të ndjekura nga zbatimi i aktiviteteve. Angazhimi i vlerësuar kohor i pritur nga pjesëmarrësit është: 3-4 ditë secili për trajnimet fizike, 1 ditë për trajnimin online dhe deri në 1 ditë për sesionet e mentorimit – në total rreth 10 ditë të shpërndara gjatë 9 muajve.

Trajnimet me prani fizike planifikohen të zhvillohen në Mal të Zi dhe Shqipëri. Kostot e udhëtimit për pjesëmarrjen në trajnimet fizike do të mbulohen nga GIZ.

Programi do të zhvillohet kryesisht në anglisht me përkthim të simultan në gjuhët lokale.



Programi fokusohet në praktikat e mira, qasjet dhe praktikat e suksesshme në promovimin e punësimit gjithëpërfshirës, kontekstin ligjor si në nivel kombëtar ashtu edhe në lidhje me kriteret e anëtarësimit në BE, sfidat dhe përfitimet e punësimit dhe lidershipit gjithëpërfshirës, si dhe mjetet dhe proceset praktike për promovimin e punësimit gjithëpërfshirës.

3. Audienca e synuar e programit

Programi LEAP bashkon përfaqësues të 8 bashkive në 4 vende dhe të paktën një partner lokal biznesi për çdo bashki. Deri në 4 persona staf në nivel C ose menaxhim të mesëm, BNJ, anëtarë të këshillit dhe përfaqësues të ngjashëm për çdo aplikim do të nominohen si pjesëmarrës në Programin LEAP.

Programi ofron një mundësi të mirë për bashkitë dhe bizneset me vizion të përkushtuara ndaj praktikave dhe politikave gjithëpërfshirëse të punësimit, duke u bërë kështu udhëheqës të komuniteteve përparimtare dhe gjithëpërfshirëse. Ne po kërkojmë agjentë ndryshimi brenda sektorit privat dhe qeverisjes lokale, të interesuar për të krijuar partneritete me shumë palë të interesuara për punësim gjithëpërfshirës. Draftimi i procesit të aplikimit mund të niset dhe udhëhiqet qoftë bashkia ose nga partneri i biznesit

Në nivel bashkiak, Programi synon stafin bashkiak në nivel mesatar, si drejtuesit e departamenteve dhe anëtarët e këshillave bashkiakë. Këta individë do të trajnohen për të vepruar si agjentë ndryshimi, me fokus ndërtimin e kapaciteteve të tyre për të avokuar dhe/ose zbatuar politika gjithëpërfshirëse të punësimit në nivel lokal.

Në sektorin privat, Programi synon nivelin C, si Drejtorët e Burimeve Njerëzore, ose menaxherët e nivelit të mesëm, duke synuar t'i pajisë ata me aftësitë dhe njohuritë për të vepruar si agjentë të ndryshimit pozitiv dhe për të promovuar dhe zbatuar politika punësimi gjithëpërfshirëse brenda kompanive dhe rrjeteve të tyre të biznesit.

Konsorciumi i përbërë nga bashkia dhe partnerët e biznesit mund të emërojë deri në katër përfaqësues në total që do të marrin pjesë në Program. Ne këshillojmë dy përfaqësues për çdo bashki dhe, në rast aplikimi në partneritet me dy biznese, një përfaqësues për çdo biznes.

4. Qëllimi dhe Rezultati i Programit

Programi LEAP krijon një platformë të strukturuar për dialog dhe bashkëpunim midis aktorëve publikë dhe privatë për të identifikuar së bashku zgjidhje praktike për punësim gjithëpërfshirës, promovim dhe pjesëmarrje në tregun e punës. Forcon kapacitetet e stafit drejtues dhe menaxherial për të dizajnuar dhe prezantuar politika dhe praktika të punësimit gjithëpërfshirës dhe u mundëson atyre të krijojnë partneritete me shumë palë të interesuara.

Programi u mundëson atyre të:

- Veprojnë si agjentë ndryshimi për punësimin gjithëpërfshirës, duke zbatuar iniciativa dhe duke rritur ndërgjegjësimin mbi praktikat e punësimit gjithëpërfshirës
- Prezantojnë ose rishikojnë praktikat ekzistuese të menaxhimit të burimeve njerëzore
- Krijojnë partneritete me shumë palë të interesuara për praktika dhe politika gjithëpërfshirëse të punësimit.

5. Përfitimet e Programit

Bashkitë dhe bizneset pjesëmarrëse do të përfitojnë nga:

- Mjete dhe metodologji praktike si dhe mentorim individual dhe mbështetje teknike nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë në zhvillimin e planeve të veprimit për politika dhe praktika gjithëpërfshirëse të punësimit, duke mundësuar që bizneset të arrijnë dhe tërheqin grupe talentesh të nën-përfaqësuara, të reduktojnë rotacionin e stafit dhe të sigurojnë mbajtjen e fuqisë punëtore të kualifikuar;
- Mundësi shkëmbimi dhe rrjetëzimi me bashkitë dhe bizneset nga Ballkani Perëndimor;
- Kuptim i përmirësuar i standardeve të BE-së dhe praktikave të mira lidhur me mundësitë e barabarta dhe përfshirjen në tregun e punës;
- Mundësi për të krijuar dhe forcuar partneritete lokale për promovimin gjithëpërfshirës të punësimit;
- Rritja e dukshmërisë rajonale si kampionë lokalë të punësimit gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrjes në fuqinë punëtore.

6. Angazhimi dhe Kërkesat

Përfaqësuesit e emëruar pritet të:

- Të kenë një rol të menaxherial të mesëm ose në nivel C, BNJ (Drejtor), ose të ngjashëm, ose të jenë anëtarë Këshillit Bashkiak ose të ngjashëm
- Të marrin pjesë aktivisht në të gjitha modulet e Programit LEAP
- Të mbështetur nga Programi, tëangazhohen, të përgatisin dhe zbatojnë plane veprimi për politika dhe praktika gjithëpërfshirëse të punësimit.

Bashkitë dhe bizneset pjesëmarrëse pritet të:

- Sigurohen që përfaqësuesit e nominuar të mund të marrin pjesë në trajnime dhe sesione mentorimi – oraret janë hartuar me fleksibilitet në mendje për t'iu përshtatur kalendarëve të ngarkuar të menaxhimit

- Të tregojnë angazhim institucional për avancimin e praktikave gjithëpërfshirëse të punësimit brenda organizatës/institucionit të tyre
- Të mbështesin krijimin dhe funksionimin e partneriteteve lokale me shumë palë të interesuara për punësim gjithëpërfshirës.

7. Procesi i Aplikimit

Bashkitë pjesëmarrëse duhet të aplikojnë së bashku me të paktën një partner lokal biznesi. Aplikimet mund të përgatiten në anglisht ose në gjuhën lokale, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Formularin e Aplikimit dhe duhet të përfshijnë të gjitha informacionet e kërkuara.

Bashkitë e interesuara duhet të dorëzojnë formularin e plotësuar të aplikimit me e-mail në adresën e mëposhtme: biljana.dijanisieva@giz.de.

Afati i fundit: 13.11.2026

Subjekti: Aplikimi: Programi LEAP, Emri i Bashkisë, Vendi

Aplikimet e paplota ose aplikimet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në konsideratë.